

Përmbajta:

1. Hyrje
2. Veprimtari kryesore
3. Formimi fillestar
4. Formimi vazhdues
5. Aktivitete të Shkollës

Të nderuar;

Ju prezantojmë me numrin e pestë të **Buletinit Informativ të Shkollës së Magjistraturës**, mbi veprimtarinë e saj akademike dhe administrative gjatë muajit qershor.

Formimi Fillestar Zemra e magjistratëve të rinj

Muaji qershor

Muaji qershor përkon me përmbylljen e Programit të Formimit Fillestar dhe, si i tillë, karakterizohet nga një intensitet i lartë aktivitetesh, vlerësimesh dhe procesesh përmbylëse të formimit profesional.

Ky muaj shënon gjithashtu një moment të rëndësishëm në rrugëtimin e kandidatëve të vitit të tretë, të cilët, pas përfundimit me sukses të gjithë detyrimeve akademike dhe praktike, diplomohen dhe përgatiten për të ushtruar funksionin e tyre në shërbim të sistemit të drejtësisë.

Në kuadër të përmbylljes së detyrimeve përfundimtare ndaj Shkollës, kandidatët e vitit të tretë, më datë 3 qershor, iu nënshtruan testimit psikologjik me shkrim, ndërsa në datat 11–12 qershor vijuan me zhvillimin e testimit psikologjik me gojë.



Aktivitetet kryesore

- Zhvillimi i procesit mësimor nga e hëna në të premte, nga ora 8:30 deri në orën 16:50.
- 2 qershor 2026 vlerësimi në modulën “E drejtë e mjedisit”.
- 4 qershor 2026 vlerësimi në modulën “Gjykimi i mosmarrëveshjeve të punës”.
- 8 qershor vlerësimi në modulën “Kontratat”.
- 12 qershor vlerësimi në modulën “Gjykimi i gjykatës dhe digjitalizimi”.
- 24 dhe 25 qershor 2026 provimi përfundimtar i vitit të dytë.
- 26 qershor vlerësimi në modulën “Arsyetimi ligjor dhe mendimi kritik”.
- 29 qershor vlerësimi në modulën “Gjykimi tregtar dhe i kompanive”.
- 29 qershor 2026 diplomimi i kandidatëve të vitit të tretë.
- 30 qershor 2026 provimi përfundimtar i ndihmës dhe këshilltarëve ligjorë.

Viti i parë

Viti akademik 2025–2026, gjatë muajit qershor, përmbylli me sukses procesin e vlerësimeve përfundimtare, duke realizuar në këtë mënyrë në tërësi Programin e Formimit Fillestar. Ky program u karakterizua nga ndryshime të rëndësishme, jo vetëm në aspektin përmbajtësor, por edhe në

dimensionin metodologjik dhe atë organizativ, duke reflektuar një qasje më të avancuar dhe bashkëkohore në procesin e formimit profesional. Në kuadër të përmbushjes së detyrimeve akademike, kandidatët për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë iu nënshtruan gjithashtu provimit përfundimtar, i cili përfshinte katër lëndë kryesore, duke konsoliduar njohuritë dhe kompetencat e fituara gjatë gjithë periudhës së formimit.



arsimorë, por edhe ndërtimin e vlerave që do të udhëheqin ushtrimin e përgjegjësisë në sistemin e drejtësisë.



Viti i tretë

Viti i dytë

Provimi përfundimtar i vitit të dytë

Gjatë muajit qershor 2026, kandidatët për magjistratë të vitit të dytë iu nënshtruan provimit përfundimtar të këtij viti studimor. Ky provim u zhvillua në formën e katër rasteve praktike, të cilat synonin vlerësimin e aftësive profesionale dhe aplikimit të njohurive në situata konkrete.

Procesi i provimit u organizua dhe u zhvillua gjatë dy ditëve, konkretisht më datat 24 dhe 25 qershor 2026, në përputhje me standardet dhe kërkesat e përcaktuara nga programi i formimit fillestar.

“Suksesi i këtij viti akademik reflekton jo vetëm përmbushjen e objektivave



Shkolla e Magjistraturës organizoi ceremoninë e diplomimit të brezit 2023–2026, duke shënuar përfundimin e suksesshëm të programit trevjeçar të Formimit Fillestar. Ky aktivitet përbën një moment të rëndësishëm në kurorëzimin e përgatitjes profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve të rinj.



“Rruga e formimit përmbyllet sot, por misioni për drejtësi fillon nesër — me integritet, përkushtim dhe përgjegjësi të plotë.”

Ceremonia u zhvillua në një atmosferë solemne dhe u përshëndet nga autoritete të larta të sistemit të drejtësisë dhe përfaqësues të institucioneve vendase dhe ndërkombëtare. Në emër të të diplomuarve u përcollën mesazhe falënderimi dhe angazhimi për ushtrimin e detyrës me përgjegjësi të lartë.

Në këtë ceremoni u diplomuan 63 magjistratë të rinj, prej të cilëve 38 gjyqtarë dhe 25 prokurorë. Diplomimi i tyre përfaqëson përmbylljen me sukses të një etape të rëndësishme formimi dhe njëkohësisht hap një kapitull të ri në shërbim të drejtësisë dhe shtetit të së drejtës.

“Ky vit akademik përmbyllet me arritje të rëndësishme dhe përgatitje të denjë, duke vendosur themelet e një karriere të ndershme dhe profesionale në sistemin e drejtësisë.”

Formimi Vazhdues

Gjatë muajit qershor 2026, Shkolla e Magjistraturës zhvilloi 24 aktivitete trajnuese në kuadër të Programit të Formimit Vazhdues, me pjesëmarrjen e gjyqtarëve, prokurorëve dhe subjekteve të tjera ligjore nga të gjitha nivelet e sistemit të drejtësisë. Aktivitetet u fokusuan në forcimin e kapaciteteve profesionale, unifikimin e praktikës gjyqësore dhe përafrimin me standardet ndërkombëtare.

Këto trajnime u ndoqën në total nga 541 pjesëmarrës (numër total pjesëmarrësish).

Muaji qershor 2026 u karakterizua nga një kalendar intensiv aktiviteteve trajnuese në kuadër të Programit të Formimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Gjatë këtij muaji u zhvilluan trajnime në fushat e së drejtës penale, civile dhe administrative, si edhe në aftësitë profesionale

dhe temat ndërdisiplinore, duke përfshirë një numër të konsiderueshëm aktiviteteve të organizuara në bashkëpunim me partnerë ndërkombëtarë.

Projekti i Binjakëzimit (Twinning Project)

Një pjesë e rëndësishme e aktiviteteve të muajit u zhvillua në bashkëpunim me Projektin e Binjakëzimit, duke sjellë ekspertizë ndërkombëtare në fusha kyçe të funksionimit të sistemit të drejtësisë.

Trajnimet përfshijnë:

- Hartimin e arsytimit ligjor për prokurorët, me pjesëmarrjen e ekspertëve ndërkombëtarë.



Trajnim 1 qershor 2026

- Trajnimin 2-ditor për kandidatët e vitit të tretë mbi paraqitjen publike dhe aftësitë joligjore;



Trajnim 8-9 qershor 2026

Këshilli i Evropës

Në bashkëpunim me Këshillin e Evropës u zhvilluan disa aktivitete të rëndësishme, ndër të cilat:

- dy sesione mbi hetimin financiar pro aktiv të rasteve komplekse të pastrimit të parave, të zhvilluara në Vlorë dhe Shkodër;



Trajnim 9-10 qershor, Vlorë



Trajnim 11-12 qershor, Shkodër

Trajnimi i trajnerëve (ToT) mbi nenin 5 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, kushtuar së drejtës për liri dhe siguri;



Trajnim 10-12 qershor, Durrës

Trajnimi për përdorimin e platformave të GJEDNJ-së (HUDOC dhe ECHR Knowledge Sharing Platform), dedikuar këshilltarëve dhe ndihmësve ligjorë.



Trajnim 23 qershor 2026, Tiranë

Këto aktivitete kontribuojnë në forcimin e zbatimit të standardeve të Konventës Evropiane dhe jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

UNDP

Në bashkëpunim me UNDP u zhvilluan dy tema të modulit "*Dhuna me bazë gjinore*", ku u trajtuan:

- hetimi dhe ndjekja penale e rasteve të dhunës me bazë gjinore;
- efektiviteti i urdhrave të mbrojtjes;
- mbrojtja procedurale e viktimave;
- sfidat që lidhen me dhunën digjitale dhe standardet më të fundit ndërkombëtare.

Trajnimet sollën diskutime mbi praktikën gjyqësore shqiptare dhe zhvillimet e fundit në kuadrin evropian.

Era – Akademia e të Drejtës Evropiane

Në bashkëpunim me ERA u zhvillua aktiviteti pan-evropian mbi ligjin e Bashkimit Evropian për barazinë gjinore, duke promovuar njohjen e standardeve evropiane dhe shkëmbimin e praktikave ndërmjet profesionistëve të drejtësisë.



Aktivitet trajnues pan-evropian, 4-5 qershor 2026

EU4LEA dhe Shkolla Italiane e Magjistraturës

Në bashkëpunim me projektin EU4LEA dhe Shkollën e Italiane të Magjistraturës u zhvillua trajnimi tre-ditor online mbi bashkëpunimin gjyqësor në çështjet penale në kuadër të proceseve evropiane të digjitalizimit të drejtësisë, me fokus instrumentet moderne të bashkëpunimit ndërkufitar.

Në bashkëpunim me projektin EU4LEA u zhvillua trajnimi dy-ditor mbi vendin e ngjarjes për prokurorë dhe oficerë të policisë gjyqësore, pranë Akademisë së Sigurisë.



Trajnim 30 qershor – 1 korrik 2026

OSBE

Në bashkëpunim me OSBE u zhvillua trajnimi për njësitë ligjore të gjykatave mbi shkrimin, kërkimin dhe arsyetimin ligjor, duke mbështetur zhvillimin profesional të këshilltarëve dhe administratës gjyqësore.



Trajnim 24 qershor 2026

Përveç aktiviteteve të organizuara në bashkëpunim me partnerët institucionalë, gjatë muajit qershor u zhvilluan edhe modulet e programit të rregullt të formimit vazhdues, të fokusuara në tema të rëndësishme të së drejtës penale, civile dhe administrative, si dhe në zhvillimin e aftësive profesionale të magjistratëve. Trajnimet trajtuan çështje që lidhen me provat dhe ekspertimin, shqyrtimin e akteve administrative, trafikimin e qenieve njerëzore, procedurat e arbitrazhit, ndihmën juridike të garantuar nga shteti, arsyetimin ligjor, menaxhimin gjyqësor dhe digjitalizimin e proceseve gjyqësore.

Nëpërmjet këtyre aktiviteteve, Shkolla e Magjistraturës vijoi të mbështesë zhvillimin e vazhdueshëm profesional të gjyqtarëve, prokurorëve dhe aktorëve të tjerë të sistemit të drejtësisë, duke kontribuar në forcimin e cilësisë së vendimmarrjes dhe harmonizimin e praktikës me standardet kombëtare dhe evropiane.

Aktivitetet të Shkollës

Ceremonia përmbyllëse e Projektit të Binjakëzimit: "Forcimi i efikasitetit, integritetit dhe profesionalizmit të sistemit të drejtësisë duke përmirësuar kapacitetin e Shkollës së Magjistraturës në Shqipëri".

Në Shkollën e Magjistraturës zhvilloi në 6 qershor ceremoninë përmbyllëse të Projektit të Binjakëzimit: *"Forcimi i efikasitetit, integritetit dhe profesionalizmit të sistemit të drejtësisë duke përmirësuar kapacitetin e Shkollës së Magjistraturës në Shqipëri"*, projekt i cili u zbatua nga Shkolla e Magjistraturës e Republikës së Shqipërisë, si shkolla përfutuese e këtij projekti binjakëzimi, dhe tre nga shkollat më të mira europiane: Shkolla Franceze e Magjistraturës (ENM), Shkolla Holandeze e Magjistraturës (SSR) dhe Shkolla Italiane e Magjistraturës (SSM), si kontributore të drejtpërdrejta në përbushjen e objektivave të projektit.

Arritjet e projektit dhe sfidat për të ardhmen ishin në qendër të fjalëve përshëndetëse të personaliteteve të sistemit të drejtësisë, Ambasadorit të Bashkimit Europian dhe trupit diplomatik të vendeve të konsorciumit implementues të projektit, të cilët theksuan rëndësinë e vijimësisë së zbatimit të reformave të nisura dhe rolin thelbësor që ka Shkolla e Magjistraturës, jo vetëm në formimin ligjor dhe profesional të magjistratëve, por edhe në kultivimin e vlerave njerëzore, si esenciale për një drejtësi cilësore.

Disa tregues rreth projektit

Projekti nisi në qershor 2024 dhe u strukturua rreth tre komponentëve kryesorë: Trajnimi Fillestar, Trajnimi Vazhdues dhe Provimi i Pranimit.

Rezultatet e arritura tregojnë një vrull të vërtetë për reforma.

Komponenti 1: Trajnimi Fillestar

- Të gjitha kurrikulat e vitit të parë janë ridizajnuar dhe validuar plotësisht, dhe viti i dytë ka filluar me një program mësimor mbi tema jo-ligjore.

- Programet e reja janë zbatuar dhe monitoruar që nga fillimi i vitit akademik 2025.

- Ekipet e mësimdhënies shqiptare (trajnuar të përhershëm dhe jo-të përhershëm) kanë treguar një angazhim të fortë dhe tani po e drejtojnë vetë reformën.

- Puna vazhdon në vitin e dytë dhe të tretë me një ekip të plotë SoM që i kupton objektivat, procedurat dhe çfarë i nevojitet për të arritur qëllimin e tij.

Komponenti 2: Trajnimi i Vazhdueshëm

- Katalog i ri i trajnimit të vazhdueshëm, metodologji e përmirësuar, 8 fusha dhe specializime të reformuara, koordinatore dhe marrëdhënie të ngushta me këshillat

- Trajnimi është më fleksibël, modern dhe i arritshëm.

- Projekti i kushton vëmendje të madhe dixhitalizimit dhe zhvillimit të e-learning.

Komponenti 3: Provimi i Pranimit

- Ndarja e konkurseve për magjistratë dhe ndihmës ligjorë.

- Rishikim përmbytësor i dy fazave të provimit hyrës

- Plan ambicioz për reformimin e fazës së tretë të provimit hyrës përmes provimit me gojë.





Shkolla e Magjistraturës zhvilloi me datën 29 qershor Ceremoninë e Diplomimit të Kandidatëve për Magjistratë të brezit 2023-2026 si dhe Konferencën Kombëtare me tematikë “Ndërveprimi i Drejtësisë me Median. Sfidat Bashkëkohore”.

Konferenca i nisi punimet me fjalët përshëndetëse nga Drejtori i Shkollës së Magjistraturës, Z. Arben Rakipi, Kryetari i Gjykatës së Lartë dhe Kryetari i Këshillit Drejtues të Shkollës, Z. Sokol Sadushi, Ambasadori i Bashkimit Evropian në Shqipëri, Z. Silvio Gonzato, Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, Z. Ilir Rusi, Kryetarja e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Znj. Mirela Bogdani, dhe Prokurori i Përgjithshëm i Republikës, Z. Olsian Çela.

Në fjalën e tij të hapjes, Z. Arben Rakipi, e vuri theksin tek rëndësia e ndërveprimit të drejtësisë me median si një marrëdhënie e domosdoshme, delikate dhe e vështirë. Ai theksoi nevojën për një koordinim për trajnime të përbashkëta, forume profesionale për të shkëmbyer praktikat më të mira që ndihmojnë në ndërtimin e një marrëdhënieje më të shëndetshme. Ai e konsideroi raportin e sistemit të drejtësisë me median një temë që qëndron në zemër të çdo shoqërie demokratike.

Kryetari i Gjykatës së Lartë, Z. Sokol Sadushi, në fjalën e tij, theksoi se të bëhesh magjistrat nuk është thjesht arritja e një kualifikimi profesional, por pranimi i një përgjegjësie publike gjatë gjithë jetës. Ai argumentoi se, ndërsa njohuritë ligjore dhe kompetenca teknike janë thelbësore, cilësitë që e përcaktojnë vërtet një magjistrat janë integriteti, karakteri, paanshmëria, përlësia dhe guximi për të zbatuar ligjin pavarësisht presionit publik, shqyrtimit mediatik ose vetmisë së vendimeve të vështira.

Ambasadori i BE-së, Silvio Gonzato, theksoi rolin e rëndësishëm që magjistratët e rinj do të kenë në forcimin e shtetit të së drejtës dhe avancimin e reformës në drejtësi në Shqipëri. Ai nënvizoi se: “Ndërsa Shqipëria vijon t’i afrohet qëllimit për t’u bërë anëtare e BE-së, roli i magjistratëve bëhet edhe më i rëndësishëm. Ky rol kërkon integritet, pavarësi, guxim, por edhe përlësi. Reforma në drejtësi mund të arrihet plotësisht vetëm nëse vendimet do të bazohen mbi këto parime”. Ambasadori Gonzato vijoi duke theksuar vijimësinë e mbështetjes për Shkollën e Magjistraturës dhe sistemin shqiptar të drejtësisë. Në fjalën e tij, Z. Ilir Rusi, e vuri theksin tek diplomimi, jo si fundi i studimeve akademike, por si fillimi i një misioni publik kërkues në sistemin e drejtësisë. Ai i kujtoi magjistratëve të sapo diplomuar se përgjegjësia e tyre më e madhe është të mbështesin ligjin me njohuri, guxim, paanësi dhe integritet të palëkundur. Ai theksoi

më tej se besimi publik nuk fitohet përmes fjalëve apo titujve, por përmes vendimeve të drejta, sjelljes etike, respektit për dinjitetin njerëzor dhe profesionalizmit të qëndrueshëm.

Në fjalën e tyre, Znj. Bogdani dhe Z. Çela përshëndetën diplomimin e kandidatëve si një prurje e rëndësishme e Shkollës në sistemin e drejtësisë si dhe njëkohësisht theksuan rëndësinë e trajtimit të tematikës së ndërveprimit dhe marrëdhënies së prokurorisë me median si një instrument i rëndësishëm për informimin korrekt të publikut.

Më tej, Konferenca i vijoi punimet me 3 panele të ndryshme që trajtuan marrëdhënien e drejtësisë me median në këndvështrime të ndryshme të aktorëve përkatës të sistemit të drejtësisë.

Paneli I i Konferencës trajtoi tematikën e "Balancimit të pavarësisë profesionale dhe perceptimit publik në vendimmarrjen gjyqësore me panelistë, Z. Sokol Sadushi Kryetar i Gjykatës së Lartë, Znj. Dineke de Groot, Kryetare e Gjykatës së Lartë të Hollandës dhe Z. Zylyftar Bregu, gazetar dhe pedagog në Departamentin e Gazetarisë së Universitetit të Tiranës.

Në fjalën e tij, Kryetari i Gjykatës së Lartë dhe Kryetar i Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës, Z. Sokol Sadushi, e vuri theksin tek përgjegjësia dhe integriteti që duhet të ketë magjistrati për të mos lejuar asnjë ndikim të papërshtatshëm në vendimmarrje dhe dhënien e drejtësisë. Nga ana tjetër ai theksoi se magjistratet duhet të jenë transparentë dhe të komunikojnë brenda kufijve që lejon ligji dhe etika, dhe të vendosin një marrëdhënie të drejtë me median.

Nga Kryetarja e Gjykatës së Lartë të Hollandës u sollën standardet kushtetuese konventore dhe të BE-së për transparencën dhe marrëdhënien ndërmjet drejtësisë dhe medias. Ajo theksoi se gjyqësori jo vetëm të ndërtojë marrëdhënie të drejta me median, por të mbrojë lirinë e shprehjes dhe të medias, sepse liria e shprehjes është një funksion i rëndësishëm i demokracisë. Ajo i

theksoi standardet duke i pare nga perspektiva evropiane e magjistratures në shqipëri, për të pasur një balancë të drejtë ndërmjet paanshmërisë dhe integritetit të sistemit gjyqësor dhe komunikimit me median dhe transparencën me publikun.

Gazetari Zylyftar Bregu, prezantoi të dhënat e sondazhit të zhvilluar me rreth 260 magjistratë me të dhënat interesante, duke përcjellë rekomandime për tu adresuar nga institucionet, duke theksuar trajnimet përkatëse për një kuptim më të mirë të raporteve dhe standardeve ndërmjet drejtësisë dhe medias. Për një komunikim më të hapur dhe të vendosjes së një besimi ndërmjet medias dhe sistemit të drejtësisë.

Paneli II trajtoi Strategjitë e Komunikimit Institucional me publikun dhe median, me kontribues Z. Ilir Rusi, Kryetar i Këshillit të Lartë Gjyqësor, Znj. Mirela Bogdani, Kryetare e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Z. Arqilea Koça, zv/Prokuror i Përgjithshëm dhe znj. Flutura Kusari, Këshilltare e Lartë Ligjore në Qendrën Evropiane për Lirinë e Shtypit dhe Medias. Panelistët diskutuan kryesisht për rolin e organeve qendrore të sistemit të Drejtësisë në përcaktimin e strategjive të duhura të komunikimit me publikun dhe median, domosdoshmërinë e vlerësimit të këtij komunikimi për të rritur besimin publik ndaj drejtësisë, si nga pikëpamja e standarteve ndërkombëtare dhe zbatimi i tyre nga organet vendase të Drejtësisë.

Në fjalën e tij, Z. Rusi, nënvizoi se komunikimi efektiv institucional është thelbësor për forcimin e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë, duke theksuar se transparenca nuk është më një funksion dytësor, por një element thelbësor i administrimit modern gjyqësor.

Z. Bogdani, nënvizoi rëndësinë e arsytimit të vendimeve për të përcjellë tek publiku besueshmërinë lidhur me funksionimin e institucioneve gjyqësore.

Z. Koça argumentoi se komunikimi efektiv është një shtyllë strategjike e shërbimeve moderne të

prokurorisë, thelbësore për forcimin e besimit publik, duke ruajtur njëkohësisht integritetin e sistemit të drejtësisë. Ai shpjegoi se si prokuroria mund të balancojë transparencën me detyrimet ligjore, siç janë sekretet hetimor, prezumimi i pafajësisë dhe mbrojtja e viktimave dhe privatësia në një epokë të informacionit të shpejtë dixhital dhe dezinformimit, duke arritur në përfundimin se besimi i qëndrueshëm midis prokurorisë dhe publikut arrihet jo përmes promovimit institucional ose heshtjes, por përmes komunikimit të saktë, në kohë, etik dhe ligjërues të shëndoshë që e bën drejtësinë më të kuptueshme, të llogaridhënës dhe të përgjegjshme ndaj shoqërisë.

Në fjalën e saj, Zj. Kusari i kushtoi rëndësi nevojës për transparencë në komunikimin publik si kusht i domosdoshëm për rritjen e besimit të publikut tek sistemi i drejtësisë.

Paneli i III trajtoi tematikën e Etikës dhe Konfidencialitetit në komunikimin e Proceseve Gjyqësore. Në këtë panel me kontribues gjyqtaren, Znj. Edlira Petri, prokurorin Z. Gëzim Spahiu dhe gazetarin Z. Armand Mero u diskutua ceshtja e transparencës dhe konfidencialitetit e proceseve gjyqësore si dhe rolin që luan etika profesionale e magjistratit dhe gazetarëve në ekuilibrin midis transparencës dhe detyrimit për të komunikuar me publikun dhe nevojës për të ruajtur sekretin hetimor të percaktuar nga ligji.

Konferenca e mbyll me bërjen e konkluzioneve të saj nga Drejtori i Shkollës, Z. Arben Rakipi,



Ju ftojme të vizitoni rregullisht faqen zyrtare të Shkollës së Magjistraturës për informacion të përditësuar mbi programet dhe veprimtaritë tona.

Me respekt,
Shkolla e Magjistraturës

www.magjistratura.edu.al

E-mail: info@magjistratura.edu.al